

Hapet Thirrja për Aplikime për mësimdhënie për stafin akademik të UT-së në Universitetin e Padovës, Itali

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për mobilitete për mësimdhënie për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Padovës, Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Mësimdhënie për stafin akademik (Periudha : Mars 2017- Qershor 2017)

Kohëzgjatja e mobilitetit:

- 17 ditë;

Fushat e mobilitetit:

Literaturë dhe linguistikë.

Për t'u njohur me katalogun e programeve të mobilitetit të ofruara nga Universiteti i Padovës klikoni në adresën:

<http://www.unipd.it/en/>

Mobiliteti përfshin:

- Kompensimin 140 Euro në ditë për 14 ditët e para dhe 98 Euro në ditë duke filluar nga dita e 15;

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze/italiane);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze/italiane në nivelin B2 sipas kursit që do të zhvilloni ;
- Plani i mobilitetit për trajnim*;
- Vërtetim nga fakulteti që ju lejon të shkëputeni për të kryer mobilitetin.

**Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:*

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

KUJDES! Kur të sillni në rektorat planin e mobilitetit për t'u firmosur nga Z. Skendaj, duhet të bashkangjisni edhe dokumentin e vërtetimit nga fakulteti juaj që ju lejon të shkëputeni gjatë kohës së trajnimit për të kryer mobilitetin.

Afati për aplikim: 4 Nëntor 2016

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentat dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori për Marëdhëniet me Jashtë.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!